

VENDIM
Nr. 540, datë 6.8.2014

PËR PEZULLIMIN E VEPRIMTARISË SË DISA INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 45, pika 4, e 63, pika 4, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Pezullimin e veprimtarisë së disa institucioneve private të arsimit të lartë, për një periudhë deri në dy vjet, duke mos lejuar regjistrimin e studentëve të rinj, deri në plotësimin kriterëve ligjore e nënligjore, të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

II. Institucionet private të arsimit të lartë të cilave do t’u pezullohet veprimtaria janë:

1. Institucioni privat i arsimit të lartë “Akademia Profesionale e Biznesit”;
2. Institucioni privat i arsimit të lartë “Kolegji profesional “NEW GENERATION””;
3. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë private “Justicia””;
4. Institucioni privat i arsimit të lartë “Universiteti “Aldent””;
5. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT”;
6. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia””;
7. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë universitare jopublike “Sevasti dhe Parashqevi Qiriazhi””;
8. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë universitare “Instituti Kanadez i Teknologjisë””;
9. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë universitare “Wisdom University””;
10. Institucioni privat i arsimit të lartë “Kolegji profesional “IVOCLAR VIVADENT & PARTNERS””;
11. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e lartë private “Hëna e Plotë” (BEDËR)”;
12. Filiali Berat “Albanian University”, (pjesë e universitetit privat “Albanian University”);
13. Shkolla e lartë private “Logos”.

III. Institucionet private të arsimit të lartë, të përmendura në pikën II të këtij vendimi, kanë detyrimin të mos regjistrojnë studentë të rinj në asnjë nga programet e studimit që ata ofrojnë (përfshi studentë në vitin e parë, në vite të ndërmjetme apo dhe transferime), për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së pezullimit të veprimtarisë.

IV. Institucionet private të arsimit të lartë, të parashikuara në pikën II të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, një raport të detajuar mbi të gjitha masat e marra në zbatim të rekomandimeve dhe gjetjeve të paraqitura në raportin e miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, që dëshmojnë plotësimin e të gjitha kriterëve të ligjshmërisë, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës në mbështetje të tij.

V. Ministri i Arsimit dhe Sportit është përgjegjës për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në këto institucione. Ai ngre grupe pune për inspektimin dhe verifikimin e situatës lidhur me zbatimin e ligjshmërisë dhe detyrimet e tjera të institucioneve private të arsimit të lartë. Bazuar në rezultatet e inspektimit, kur gjen se institucioni ka përmbushur kriteret ligjore e nënligjore, i propozon Këshillit të Ministrave, rast pas rasti, heqjen e masës së marrë për pezullimin e veprimtarisë.

VI. Institucionet private të arsimit të lartë, të përmendura në pikën II, nuk mund t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe akreditimit gjatë periudhës së pezullimit të veprimtarisë, deri në përmbushjen e kriterëve ligjore e nënligjore.

VII. Për të gjitha institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk do të marrin masa për plotësimin e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ministria e Arsimit dhe Sportit i propozon Këshillit të Ministrave, rast pas rasti, heqjen e licencës dhe ndërprerjen përfundimtare të veprimtarisë.

VIII. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës V të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, programi “Kërkimi shkencor”, llogaria “Të ardhura”.

IX. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të gjitha subjektet juridike, përfaqësuese të institucioneve private të arsimit të lartë, të përmendura në pikën II për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama